



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 9 / 9 / 2025

Lënda: Njoftim për shpallje të vendeve të lira për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2025 – 2026.

NJOFTIM

Për shpallje vende të lira për pedagog të ftuar

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike shpall kërkesat dhe kriteret për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2025 – 2026, sipas departamenteve si më poshtë:

I. Departamenti i Automatikës, për vitin akademik 2025 – 2026.

Lëndët:

1. "PLC"
2. "Automatizim Industrial"
3. "Matje Elektronike"
4. "Matje Elektrike"
5. "Bazat e Automatikës"

Kriteret e kandidatëve mbështetur në LAL dhe në statutin e UPT janë si më poshtë:

- Të zotërojë diplomë Master i Shkencave në një nga programet e studimit të mbuluara nga Departamenti i Automatikës ose diploma ekuivalente me to;
- Nota mesatare e ponderuar për kandidatët e diplomuar në sistemin pesëvjeçar të jetë jo më pak se 8;
- Nota mesatare e ponderuar për kandidatët e diplomuar në sistemin 3+2 të jetë jo më pak se 8 në të dy ciklet e studimit;
- Nota në lëndët në të cilën kandidati do të angazhohet të jetë jo më pak se 9;
- Të ketë aftësi komunikuese pedagogjike të cilat do të tregohen nëpërmjet një interviste të zgjeruar ku kandidati do të bëjë një paraqitje të shkurtër në departament mbi një tematikë brenda disiplinës të zgjedhur nga kandidati;
- Përbën përparësi grada shkencore "Doktor" në fushat që mbulon Departamenti i Automatikës



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE

- Të ketë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive të domosdoshme tek studentët.

Numri i pedagogëve të ftuar që kërkohet për mbulimin e ketyre orëve mësimore nga departamenti është **6 (gjashtë)**.

II. Departamentit i Elektroteknikës për vitin akademik 2025 – 2026.

Lëndët:

1. *Elektroteknikë dhe Impiante, Bazat e Elektroteknikës dhe Elektroteknikë* për studentët e degëve të fakulteteve jashtë FIE, ku përfshihen leksione, seminare dhe laboratore.

Kriteret e kandidatëve mbështetur në LAL dhe në statutin e UPT janë si më poshtë:

- Të jetë i diplomuar në Inxhinieri Elektrike, Bachelor dhe Master i Shkencave apo sistemi 5-vjecar.
- Të ketë notë mesatare të ponderuar për të dy ciklet më të lartë se 8 kur ka diplomë master i shkencave dhe notë mesatare 8 kur ka mbaruar sistemin 5-vjecar.
- Mesatarja e notave në lëndët Matematikë (Analizë Matematike 1, 2, Algjebër, Analize Komplekse) Fizikë (Fizikë Eksperimentale 1, 2), Elektroteknikë (Elektroteknikë 1, 2, 3), Teori fushe elektromagnetike më e lartë se 8.
- Kanë përparësi kandidatët që zotërojnë tituj akademikë si dhe personeli akademik i ftuar pranë DE për më shumë se dy vite.
- Përbën përparësi eksperiencia në mësimdhënie në lëndë të ngjashme.
- Kandidati duhet të jetë i komunikueshëm, i aftë të punojë në grup dhe me etikë profesionale.
- Kandidatët që aplikojnë për herë të parë preferohet të kenë rekomandime nga Departamenti ku janë diplomuar apo nga vendi i tyre i punës.

Numri i pedagogëve të ftuar që kërkohet për mbulimin e ketyre orëve mësimore nga departamenti është **2 (dy)**.

III. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë për vitin akademik 2025 – 2026.

Lëndët:

1. *“Projektimi i rrjetave elektrike shpërndarëse” (leksione dhe seminare), Master Profesional.*



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE

2. “Projektimi i rrjetave elektrike civile dhe industriale”, *Master Profesional*.
3. “Analiza e Sistemeve Energjetike”, *Master Shkencor*.
4. “Platforma Kompiuterike per Analizen e Sistemeve Elektroenergjetike” (NEPLAN), *Master Shkencor*.
5. “Projektimi i rrjetave elektrike TL (LZ)”, *Master Profesional*.
6. “Projektimi i Impianteve dhe rrjetave Elektrike”, *Master Shkencor*.

Kriteret e kandidatëve mbështetur në LAL dhe në statutin e UPT janë si më poshtë:

- Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë Master Shkencor ne Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjitik, ose studimet e ciklit 5 vjecar në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Energjitik.
- Nota mesatare (ose e ponderuar) e diplomave të studimit të jetë mbi 8.0.
- Të ketë eksperiencë pune në sektorin elektroenergjetik,
- Avantazh përbën eksperiencia mësimdhënëse dhe praktike për lëndën që kërkon të angazhohet si pedagog i ftuar.
- Të ketë aftësi komunikuese për transferimin e njohurive tek studentët.

Numri i pedagogëve të ftuar që kërkohet për mbulimin e ketyre orëve mësimore nga departamenti është 4 (katër).

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentat si më poshtë, deri në datën 19/9/2025, pranë departamenteve perkatës:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Jetëshkrimi (CV).
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
4. Fotokopje e diplomës universitare dhe listës së notave të noterizuara.
5. Vërtetim nga vendi i punës, që i lejon për t’u angazhuar në mësimdhënie.